

# RAPORT VJETOR 2022



Realizuar nga Administrata e U.P.SH.

Nën kujdesin e Presidentes Znj.Valbona Treska

**RAPORT VJETOR 2022**

© URDHRI I PSIKOLOGUT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË



**Tabela e lëndës**

<b>Përshëndetja e Presidentit.....</b>	<b>5</b>
<b>1. Rrugëtimi i institucionit gjatë vitit 2022.....</b>	<b>7</b>
1.1 Dita Ndërkombëtare e Shëndetit Mendor.....	14
<b>2. Organet e Urdhrit të Psikologut dhe aktiviteti i tyre funksional.....</b>	<b>15</b>
2.1 Asambleja Kombëtare.....	16
2.2 Këshilli Kombëtar.....	18
2.3 Komisioni i Gjykimit Disiplinor Profesional.....	22
2.4 Komisioni i Edukimit në Vazhdim në Psikologji.....	23
2.5 Administrata e Urdhrit të Psikologut.....	24
2.6 Komisione të tjera.....	25
2.6.1 Komisioni i Licencimit.....	25
2.6.2 Komisioni i Praktikës Profesionale.....	26
2.7 Koordinatorët Lokalë.....	28
<b>3. Anëtarësia e Urdhrit të Psikologut.....</b>	<b>30</b>
3.1 Psikologë të licencuar.....	30
<b>4. Zhvillimi për herë të parë i Provimit të Shtetit për Psikologët.....</b>	<b>32</b>
<b>5. Buxheti.....</b>	<b>33</b>
5.1 Të ardhurat.....	33
5.2 Shpenzimet.....	33
<b>6. Objektivat e realizuar gjatë vitit 2022.....</b>	<b>36</b>
<b>7. Objektivat për vitin 2023.....</b>	<b>37</b>





## PËRSHËNDETJA E PRESIDENTIT



(Dr. Valbona Treska - Presidente)

Të nderuar kolegë e miq,

Kemi mbyllur së bashku një tjetër vit të rëndësishëm në rrugëtimin e Urdhrit të Psikologut. Ka qenë një vit me shumë arritje dhe sfidat janë dukur të papërfillshme krahasuar me rezultatet që kemi marrë.

Urdhri i Psikologut tashmë është strukturuar si në anëtarësi ashtu edhe në mënyrën e organizimit të punës. Të ardhurat janë rritur dhe padyshim përgjegjësitë janë disafish më të larta. Komisionet tona punojnë me volem të lartë pune dhe ka vijuar pa ndërprerje shkëmbimi i korrespondencave me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare.

Këshilli Kombëtar ka marrë gjatë këtij viti vendime shumë të rëndësishme lidhur me ushtrimin profesionit brenda fushës së kompetencës. Këto vendimmarrje

janë në vazhden e profilizimit të psikologëve dhe fuqizimit të çdo fushe të psikologjisë.

Kemi vijuar të jemi pjesë aktive edhe gjatë këtij viti e organizmave të rëndësishëm ndërkombëtarë siç janë Federata Europiane e Psikologëve (EFPA), Alenaca Globale e Psikologjisë, Shoqatat Europiane e Punës dhe Psikologëve Organizacionalë (EAWOP) si dhe kemi vijuar të mbajmë komunikim të vazhdueshëm me homologët tanë.

Realizimi i Asamblesë së VI Kombëtare këtë vit u bë në qytetin shumë mikëpritës të Lezhës. Me ndihmën e koordinatorëve dhe bashkëpunëtorëve tanë, arritëm të bënim bashkë një numër të lartë psikologësh pjesëmarrës nga e gjithë Shqipëria. Të mbledhurit dhe diskutuarit së bashku, është gjithmonë një kënaqësi dhe motivim për të marrë vendime të rëndësishme për psikologjinë e për të ecur përpara. Padyshim, sikundër është kthyer tashmë në traditë, përmbyllja e asamblesë është një festë e vërtetë me muzikë të mirë dhe biseda mes kolegësh.

Gjatë këtij viti kemi patur me dhjetra ngjarje mjaft të rëndësishme, të cilat na kanë bërë krenarë si dhe kanë treguar se sa i fortë dhe i bashkuar është komuniteti i psikologëve. Më lejoni të ndalem shkurtimisht tek ato më kryesoret.

Një ndër arritjet e padiskutueshme të këtij viti ishte realizimi i provimit të parë të shtetit për psikologët. Pas një pune shumë të gjatë dhe pritje të lodhshme nga secili anëtar që priste të finalizonte me sukses këtë procedurë, në maj 2022 arritëm të përmbyllnim me sukses provimin e parë të shtetit. Rreth 200 psikologë kaluan me sukses këtë fazë dhe u pajisën më pas me licencat profesionale. Ky provim i hapi rrugën normalizimit të procedurave për pajisjen me licencë profesionale bazuar në ligjin 40/2016 “Për Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë”. Provimi i shtetit do të realizohet dy herë në vit bazuar në legjisllacionin në fuqi dhe si nevojë e psikologëve që përmbyllin praktikën profesionale për t’u pajisur më pas me licencë.



## URDHRI I PSIKOLOGUT RAPORTI VJETOR 2022



Një tjetër ngjarje shumë e rëndësishme gjatë këtij viti, që bëri bashkë rreth 300 psikologë dhe qytetarë, ishte marshimi simbolik për Ditën Botërore të Shëndetit Mendor, 10 Tetor. Një orgnizim i tillë ishte i pari në vendin tonë në këtë përmasa mbi shëndetit mendor. Ishte gëzim të shihje me dhjetra qytetarë, politikanë, përfaqësues të shoqërisë civile, të cilët ju bashkuan thirrjes tonë. Me tullumbace në duar, mesazhe sensibilizuese dhe moton “Sytë nga Shëndeti Mendor” si dhe fjongo të gjelbra vendosur në xhaketa, bëmë së bashku një ecje sensibilizuese nga Sheshi “Skënderbej” në drejtim të Shëshit “Nënë Tereza”. Lëshimi i njëkohshëm i qindra tullumbaceve të gjelbër në qiell, u pasqyruan direkt në median vizive në edicionet informative, si një prej ngjarjeve më të rëndësishme të asaj dite.

Të bëje bashkë një numër aq të lartë pjesëmarrësish dhe gazetarësh, ishte ndër sfidat më të bukura të këtij viti.

Ndërkohë që UPSH u përfshi gjithashtu në përcimin e mesazheve sensibilizuese edhe në videon e realizuar nga Alenaca Globale e Psikologëve me të gjithë vendet e botës.

Përpos arritjeve të jashtëzakonshme që kemi patur të gjithë bashkë gjatë këtij viti, do dëshiroja të përmbyllja këtë përshëndetje të raportit 2022 me një arritje profesionale por edhe personale. Në qershor 2022 u mbajt në Bogota, Kolumbi Samiti i II-të i Alencës Globale të Psikologëve, në të cilin ishin të ftuar të merrnim pjesë ndër të tjerë, 75 liderë të psikologjisë në rang global. Nënshkruam një deklaratë të përbashkët mbi rolin e psikologëve në shëndetin mendor dhe ngrohjen globale. Gjatë këtij samiti, pata nderin të dekorohem nga Presidenti i Shoqatës së Psikologëve Amerikanë, Dr.Frank C. Worrell nën moton “Për lidërsip të jashtëzakonshëm në zhvillimin e Urdhrit të Psikologut në Shqipëri”. Ishte një emocion i papërshkrueshëm dhe një eksperincë unike profesionale. Kur kam nisur këtë rrugëtim të Urdhrit të Psikologut, nuk kam arritur as ta ëndërroj që do të arrija deri këtu dhe që puna e jashtëzakonshme që kemi bërë të gjithë bashkë, do të shpërblehej në këto nivele botërore.

Dekorimi si lider i suksesshëm bashkë me 7 kolegë të tjerë të psikologjisë globale, ishte vlerësimi më i lartë profesional jo vetëm individual, por për të gjithë komunitetin e psikologëve shqiptarë.

Uroj që gjatë vitit 2023 të kemi të tjera arritje së bashku, të fuqizojmë rolin e psikologut në shoqëri, të vazhdojmë të ulim stigmën e çdokujt për profesionin tonë, të rrisim vendet e punës, të rrisim të ardhurat personale të çdo profesionisti dhe mbi të gjitha t'i ofrojmë çdo qytetari shërbim dinjitoz dhe me profesionalizëm.

Përzemërsisht,  
Valbona Treska

Tiranë, Shqipëri, Janar 2023



## 1. RRUGËTIMI I INSTITUCIONIT GJATË VITIT 2022

Gjatë viti 2022, Urdhri i Psikologut, vazhdoi angazhimin e tij institucional në përmbushje të misionit të tij. Pavarësisht vështirësive dhe sfidave për të realizuar aktivitetin tonë të përditshëm, kemi arritur që edhe gjatë këtij viti të kemi një sërë aktivitete të suksesshme muaj pas muaji.

### Janar

Viti nisi me një takim online Pyetje-Përgjigje, të Presidentes së Urdhrit të Psikologut Znj.Valbona Treska, në datë 26 Janar me anëtarësinë. Në këtë takim u diskutua në lidhje me problematikat që hasin psikologët në ushtrimin e profesionit.

Në 28.01.2022 u mbushën plotë 5 vite nga themelimi i Urdhrit të Psikologut.



### Shkurt

Në muajt shkurt dhe mars u organizuan disa takime me anëtarësinë e Urdhrit në qytete të ndryshme të vendit. Në fokus të këtyre takimeve ishte prezantimi Koordinatorëve të rinj të Urdhrit të Psikologut me qarqet e tyre. Kështu gjatë kësaj periudhe u zhvilluan takime të Koordinatorëve me anëtarësinë në qarqet Gjirokastër, Vlorë, Elbasan dhe Lezhë. Në këto takime u diskutua lidhur me problematikat e anëtarëve, shqetësimet që ata hasin në përditshmërinë e tyre të punës si dhe u ngritën pyetje në lidhje me marrjen e krediteve për procesin e Edukimit në Vazhdim.



### Mars

Në datë 04.03.2022 Federata Europiane e Psikologëve të Europës (EFPA) nisi procedurat për dëbimin nga Federata të Urdhrit të Psikologëve të Rosisë. Në një mbledhje të jashtëzakonshme të vendeve anëtare të EFPA-s thirrur nga Këshilli Ekzekutiv, u vendos me mbi 85% të votave të vendeve anëtare, nisja e procedurave për dëbimin e Rosisë nga Federata. Urdhri i Psikologëve të Shqipërisë shprehu mbështetjen e fortë për Ukrainën dhe ju bashkua në votim vendeve të tjera anëtare ndaj Rosisë. Insitucioni ynë shprehet qartësisht dhe unanimisht kundra akteve të dhunës, që dëmtojnë të drejtat dhe liritë e individëve dhe vendeve demokratike dhe kemi



## URDHRI I PSIKOLOGUT RAPORTI VJETOR 2022



shprehur gadishmërinë tonë për t'i ardhur në ndihmë, jo vetëm kolegëve tanë ukrainas, por edhe popullatës që po vuan pasojat e luftës.

### Maj

Në datë 06.05.2022 u zhvillua mbledhja e Presidentëve të Federatës Europiane të Psikologëve në zyrat qendrore të EFPA-s në Bruksel. Pas një dite të gjatë pune, Presidentia e Urdhrit të Psikologut, Znj. Valbona Treska, pati edhe një takim me Z.Christoph Steinebach, Presidentin e Federatës Europiane të Psikologëve (EFPA).



parimin kryesor të një psikologu. Ajo gjithashtu njohu studentët me ndryshimet që janë bërë në Kodin e Etikës së Psikologëve, i cili ka për qëllim të garantojë mirëqenien dhe mbrojtjen e individëve dhe grupeve me të cilët punojnë psikologët dhe edukimin e anëtarëve, studentëve dhe publikut lidhur me standardet etike të disiplinës së psikologjisë.

Universiteti European i Tiranës dhe Departamenti i Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve organizuan Workshop-in me temë “Ushtrimi i profesionit brenda etikës profesionale” ku ishte e ftuar dhe Dr. Valbona Treska, Presidente e Urdhrit të Psikologut. Znj. Treska theksoi rëndësinë e etikës profesionale si







# URDHRI I PSIKOLOGUT RAPORTI VJETOR 2022



## Qershor

Këshilli Ekzekutiv i EAWOP, në të cilin Shqipëria përfaqësohet nga Dr.Valbona Treska, ka realizuar një vizitë pune, në datë 01.06.2022, në Qendrën Internacionale të Kongreseve, Katowicë për të konkluduar zhvillimin e Kongresit. Kongresi do të mbahet në Katoëice, Poloni në maj 2023. Mbledhja e rradhës e Këshillit Ekzekutiv është mbajtur pranë ambienteve të Universitetit të Silesia, Katoëicë, Poloni. Komiteti Shkencor pret të aprovojë mbi 2000 punime shkencore këtë vit.

Delegates			
Country	#votes Delegate	Country	#votes Delegate
Albania	2 Valbona Treska, Elona Mustafaraj	Ireland	3 Vincent McDarby, Megan Gaffney, Hara Kabac
Austria	6 Beate Wimmer-Puchinger, Hilde Wolf	Italy	5 Santo B. Naves, Caterina Acidacano
Belgium	3 Jan De Houwer, Lotte De Schryver	Latvia	2
Bulgaria	2 Stoyu Nedov	Liechtenstein	0
Croatia	0 Jozo Lopic	Lithuania	2 Aina Adamaityte, Robertas Povilaitis
Cyprus	2 Chrys Demetriou	Luxembourg	2
Czech Republic	2 Veronika Podlanská	Malta	2 Gail Debono, Miriam Gerardi, Gauci
Denmark	6 Des Sedenfaden, Anne Granthøj Johansen, Jøel Rosent, Mette-Sofie Arnsjov	Netherlands	6 Ruus de Vries, Michelle Troost, Blomqvist Tack, Wink Geertman
Estonia	0	Norway	6 Hilan Skard, Arvidh Lauvang, Kim E. Karlsen, Bjørnfrid Stokvik
Finland	5 Jari Iipainen, Eija Kivineva, Liira Nenonen	Poland	5 Beata Kryzewska-Jankiewicz, Andrzej Szewski
France	2 Melaine Gache	Portugal	6 Francisco Miranda Rodrigues, Sofia Ramalho, Miguel Oliveira
Germany	6 Mettem Auci-Wiering, Karl-Jens Riemer, Bianca Vaterodi, Gita Trogim-Neubert	Romania	6
Greece	2 Vasiliki Boukouvala	Russia	0 Anna Leykina
Hungary	2 Tímea Gábor Hegyvári	San Marino	2 Laura Corbelli, Riccardo Venturino
Iceland	2 Anna María Friðmannsdóttir	Serbia	2 Tamara Blazevic Ignjatovic, Snezana Milutinovic
		Observers	6 Rouleau McElveney
		Observer EAPAP	6

Gjatë muajit qershor u mbajt online Asambleja e Përgjithshme e Federatës Europiane të Psikologëve (EFPA). Shqipëria u përfaqësua në këtë event nga Presidentja Znj.Valbona Treska dhe Anëtarja e Këshillit Kombëtar Znj.Elona Mustafaraj.

Në datë 9 Qershor 2022 u promovua Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor dhe

Shoqëror. Ky aktivitet u mbajt në ambientet e Hotel Tirana dhe u organizua nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Në fjalën e saj Znj.Treska shfaqti vullnetin e UP për të bashkërenduar punën me ASCK, me qëllim dhënien e shërbimit korrekt dhe cilësor për psikologët.

Gjatë muajit qershor u zhvillua në Bogotá, Kolumbi, Samiti Ndërkombëtar mbi Psikologjinë dhe Shëndetin Global. Samiti u organizua nën kujdesin e Shoqatës së Psikologëve Amerikanë (APA) në bashkëpunim me Kolegjin e Psikologëve Kolumbianë. Presidentja Dr.Valbona Treska ishte e ftuar për të dytën herë rradhazi në këtë event, i cili është event i rëndësishëm global në psikologji, me lider të përzgjedhur vetëm nga disa shtete të botës. Znj.Treska mori pjesë në këtë event së bashku me Znj.Elona Mustafaraj, anëtare e Këshillit Kombëtar



dhe njëkohësisht anëtare e Bordit të Krizave dhe Emergjencave në EFPA. Në datë 20 Qershor 2022 u përmbyll me sukses Samiti i Aleancës Globale të Psikologjisë (Global Psychology Alliance) i mbajtur në Bogotá, Kolumbi. Në fund të Samitit liderët e



# URDHRI I PSIKOLOGUT RAPORTI VJETOR 2022



vendeve pjesëmarrëse nënshkruan një deklaratë të përbashkët mbi Shëndetin Mendor dhe Ngrohjen Globale. Në përfundim të Samitit, Presidentja e Urdhrit të Psikologut në Republikën e Shqipërisë Dr.Valbona Treska u dekorua nga Presidenti i Psikologëve Amerikanë njëkohësisht dhe drejtues i Aleancës Globale të Psikologëve, Dr. Frank C. Worrel nën moton:

**“Për lidhshmëri të jashtëzakonshme në zhvillimin e Urdhrit të Psikologut në Shqipëri”**



## Korrik

Në Revistën mujore të EFPA-s, atë të muajit Korrik 2022, në të cilën i është kushtuar një hapësirë e konsiderueshme tematikës së Ndryshimeve Klimaterike, u publikua edhe një artikull lidhur me vlerat dhe rëndësinë e jashtëzakonshme që mbart lumi Vjosa, si një nga lumenjtë e vetëm të egër të mbetur në kontinent.

Artikulli gjendet në: [https://efpa.magzmaker.com/june\\_2022/climate\\_change](https://efpa.magzmaker.com/june_2022/climate_change).



The Vjosa River


Let's save Vjosa River, the Blue Heart of Europe

By Valbona Treska, President of the Order of Psychologists of Albania

The Vjosa River in Albania is one of Europe's last living wild rivers. Its entire course of over 270 kilometers is untamed and free-flowing, with beautiful canyons, braided river sections, oxbows, meandering stretches, and islands covered with vegetation. In some areas the riverbed expands over more than 2 km in width.




Në datë 15.07.2022, Urdhri i Psikologut përcolli tek ministrinë e linjës si dhe në Kryeministri, një





# URDHRI I PSIKOLOGUT RAPORTI VJETOR 2022




Organizatës Botërore të Shëndetësisë, publikuar në datë 18.06.2022 rreth 21 vite pas raportit të fundit të OBSH mbi shëndetin mendor në 2001.

## Shtator

Në datë 21.09.2022 u realizua një takim dypalësh me Z.Claudio Mennini përfaqësues i kompanisë Giunti Psychometrics. Në këtë takim u diskutua mbi vijimin e bashkëpunimit për teste të standardizuara në tre fusha kryesore: psikologji shëndeti mendor, psikologji edukimi dhe psikologji juridike. Gjatë muajve në vijim pritet të konkretizohen trajnime dhe të dakordësohen marrëveshje për çmime të reduktuara lidhur me disa teste të standardizuara që anëtarët tanë mund të aplikojnë.

shkresë në lidhje me problematikën e shëndetit mendor, pas përfundimeve të nxjerra nga raporti i



## Tetor

Në datë 05.10.2022, u realizua një takim online me anëtarësinë e Urdhrit të Psikologut. Ky takim u realizua në kuadër të rilicencimeve, përmbushjes së krediteve, afateve dhe rregulloreve që duhet të zbatohet secili nga anëtarët tanë, si dhe duke vlerësuar me kujdes problematikën që janë hasur deri më tani.



## URDHRI I PSIKOLOGUT RAPORTI VJETOR 2022



Urdhri i Psikologut ishte pjesë e aktivitetit që u zhvillua datë 25.10.2022 “Health and Well-being forum for Youth”. Aktiviteti u organizua nga Ministria e Shëndetësisë dhe zgjati 3 ditë. Ky aktivitet synonte forcimin dhe përfshirjen e të rinjve në vendimmarrje.



### Nëntor

Në datë 18.11.2022 u zhvillua në Vilnius të Lituanisë, mbledhja e Presidentëve të Federatës Evropiane të Psikologëve (EFPA), në të cilën mori pjesë edhe vendi ynë, përfaqësuar nga Presidentja e Urdhrit të Psikologut Znj. Valbona Treska.





Në datë 24.11.2022 u realizua një sesion online “Pyetje-Përgjigje”, në lidhje me aktualitetin e punëve të organeve që funksionojnë pranë U.P. si dhe diskutimin e problematikave që shqetësojnë anëtarësinë në punën e tyre.



### Dhjetor

Edhe këtë vit shpallëm “Psikologun e Vitit 2022”. Ky është tashmë një event i kthyer në traditë çdo fundvit. Këtë vit patëm 5 psikologë të nominuar për fitimin e këtij çmimi simbolik. Fituese e çmimit “Psikologu i Vitit 2022” u shpall Znj.Brunilda Laboviti.



## 1.1 DITA NDËRKOMBËTARE E SHËNDETIT MENDOR

Në datë 10.10.2022 me rastin e Ditës Botërore të Shëndetit Mendor, u finalizua me sukses marshimi simbolik me temë “Sytë nga Shëndeti Mendor”.


Aktivitetet i këtyre përmasave dhe me një mbulim shumë të gjerë nga mediat, ishte i pari i këtij lloji në Shqipëri. Pasqyrime mediatike pati jo vetëm në median visive, por edhe në atë të shkruar. Aktivitetit iu bashkuan jo vetëm psikologë, por edhe punonjës të tjerë të shëndetësisë, studentë, përfaqësues të organizatave, pjesëtarë të shoqërisë civile, etj.

Ky marshim nisi nga Sheshi “Skënderbej” për të përfunduar në Sheshin “Nënë Tereza”, gjatë të cilit pjesëmarrësit mbajtën në duar pankarta me mbishkrime sensibilizuese në lidhje me shëndetin mendor si dhe njëzëri përçuan mesazhe drejtuar qytetarëve, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit dhe vëmendjes ndaj njerëzve që janë të prekur nga problematika të shëndetit mendor.





## 2. ORGANET E URDHRI TË PSIKOLOGUT DHE AKTIVITETI I TYRE FUNKSIONAL



Organigrama e Urdhrit të Psikologut

Organet kryesore të Urdhrit të Psikologut janë:

- a) Asambleja Kombëtare;
- b) Këshilli Kombëtar;
- c) Presidenti i Urdhrit;
- ç) Komisioni Etik i Gjykimit Disiplinor Profesional

- d) Komisioni i Edukimit në Vazhdim
- e) Komisione të tjera, ku përfshihen aktualisht Komisioni i Licencimit dhe Komisioni i Praktikave Profesionale.

## 2.1 ASAMBLEJA KOMBËTARE

- Organi më i lartë drejtues i Urdhrit të Psikologut, bazuar në ligjin nr. 40/2016, është Asambleja Kombëtare.
- Asambleja Kombëtare përbëhet nga të gjithë anëtarët e Urdhrit të Psikologut.
- Asambleja Kombëtare ka këto funksione:
- Zgjedh Këshillin Kombëtar dhe Presidentin e Urdhrit, me votim të fshehtë dhe me shumicë të thjeshtë të të gjithë anëtarëve të saj;
- Miraton statutin e Urdhrit;
- Miraton Kodin e Etikës dhe Deontologjisë;
- Miraton rregulloren për gjykimin disiplinor profesional;
- Miraton rregulloren për regjistrimin, anëtarësimin dhe licencimin;
- Miraton rregulloren për organizimin e praktikës profesionale;
- Shqyrton dhe miraton projekt-buxhetin e Urdhrit, si dhe shqyrton buxhetin faktik të tij;
- Analizon veprimtarinë vjetore të organeve të Urdhrit;
- Shqyrton raportin e auditit të jashtëm, në intervale tre vjeçare.



### Asambleja e VI-të Kombëtare, i zhvilloi punimet në ambientet e Hotel President në Shëngjin/Lezhë në datë 13.05.2022 me rend dite si më poshtë:

- Hapja e punimeve të Asamblesë së VI-të Kombëtare.
- Fjalë përshëndetëse nga Znj.Alma Shyti, në cilësinë e Koordinatorës së Qarkut Lezhë.
- Fjalë përshëndetëse nga Z.Hasan Muça, drejtues i DRAP Lezhë.
- Fjalë përshëndetëse nga Z.Besmir Frroku në cilësinë e Anëtarit të Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Psikologut të Qarkut Lezhë.
- Analizë e veprimtarisë vjetore të organeve të Urdhrit të Psikologut nga Presidentja e Urdhrit të Psikologut Znj.Valbona Treska
- Prezantim dhe miratim i buxhetit faktik të vitit 2021, miratuar nga Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Psikologut me Vendimin Nr.1, datë 29.04.2022.







- Prezantim dhe miratim i projekt-buxhetit të vitit 2022, miratuar nga Këshilli Kombëtar i Urdhrit të



Psikologut me Vendimin Nr.17, datë 29.12.2021.

- Prezantim dhe miratim i ndryshimeve të Statutit të Urdhrit të Psikologut, miratuar nga Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Psikologut me Vendimin Nr.9, datë 08.04.2022.
- Prezantim dhe miratim i ndryshimeve të Rregullores së Gjyimit Disiplinor e Profesional, miratuar nga Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Psikologut me Vendimin Nr.10, datë 08.04.2022.
- Hapësirë e lirë për diskutime.
- Mbyllja e aktivitetit.
- Asambleja u zhvillua me sukses dhe me diskutime konstruktive, duke miratuar të gjitha pikat e rendit të ditës



#### Asambleja e VI-të Kombëtare mori vendim:

- Të miratojë me shumicë votash nga 104 anëtarët prezent në Asamble, Buxhetin Faktik të vitit 2021
- Të miratojë me shumicë votash nga 104 anëtarët prezent në Asamble, Projekt-Buxhetin e vitit 2022
- Të miratojë me shumicë votash nga 104 anëtarët prezent në Asamble, ndryshimet në Rregulloren e Gjyimit Disiplinor e Profesional, përkatësisht Neni 4, pika 3.1 e tij.
- Të miratojë me shumicë votash nga 104 anëtarët prezent në Asamble, ndryshimet në Statutin e Urdhrit të Psikologut.
- Të shtohet Neni 36/1, 36/2, 36/3, 36/4 dhe 36/5 në Statutin e Urdhrit të Psikologut.



Pas punimeve të Asamblesë anëtarët patën mundësinë të shpenzonin kohë së bashku duke diskutuar dhe ndarë eksperiencat e tyre. Zhvillimi i Asambleve Kombëtare është jo vetëm një detyrim që rrjedh nga ligji, por edhe një formë për të bashkëuar më shumë profesionistët e të gjithë Shqipërisë mes tyre.

## 2.2 KËSHILLI KOMBËTAR

### KËSHILLI KOMBËTAR



Dr. Valbona Treska



Z. Edvin Lame



Z. Besmir Frroku



Dr. Fleura Shkëmbi




Dr. Manolita Hida




Z. Altin Nika



Znj. Rezarta Basha




Z. Bledar Zeneli



Znj. Valbona Habili



Znj. Artemisi Dono



Znj. Elona Mustafaraj



Znj. Orjola Plaku

Këshilli Kombëtar është organi ekzekutiv i Urdhrit, i cili përbëhet nga 16 anëtarë.

Anëtarë të zgjedhur të Këshillit Kombëtar janë:

Dr.Fleura Shkëmbi, Dr.Valbona Habili, Dr.Edvin Lame, Dr.Artemisi Dono, Znj.Elona Mustafaraj, Znj. Rezarta Basha, Dr.Manolita Hida, Znj.Orjola Plaku, Z.Besmir Frroku, Z.Altin Nika, Z.Bledar Zeneli dhe Dr.Valbona Treska në cilësinë e Presidentit.

Në përbërje të Këshillit Kombëtar janë edhe 4 anëtarë të caktuar nga Ministritë, përkatësisht nga:

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (njëkohësisht edhe Autoriteti Kompetent i Urdhrit të Psikologut sipas ligjit):

Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë

Ministria e Drejtësisë

Ministria e Mbrojtjes

Këshilli Kombëtar ka këto përgjegjësi:

- a) miraton strukturën e vet organizative;
- b) cakton kuotizacionin dhe tarifat;
- c) administron pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të Urdhrit në nivel kombëtar;
- ç) mbikëqyr të gjithë veprimtarinë e organeve që varen prej tij;
- d) harton statutin, rregulloret e Urdhrit, si dhe Kodin e Etikës dhe Deontologjisë dhe ia propozon ato për miratim Asamblesë Kombëtare;
- dh) mban dhe përditëson Regjistrin e Urdhrit të Psikologut;
- e) ngre grupe pune ad-hoc për kryerjen e kontrolleve në ushtrimin e profesionit të psikologut;
- ë) përgatit publikon raportin vjetor dhe financiar.

Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Psikologut të Republikës së Shqipërisë, përgjatë këtij viti, ka patur një aktivitet shumë të ngjeshur duke marrë një sërë vendimesh të rëndësishme gjatë vitit 2022.



## URDHRI I PSIKOLOGUT RAPORTI VJETOR 2022



### Këshilli Kombëtar ka marrë vendimet e mëposhtme:

- Vendimi Nr.1 “Për ngritjen e komisionit ad hoc për shqyrtimin e ankesës Nr. 10 prot, datë 20.01.2022 në lidhje me vendimmarrjen e Komisionit Etik dhe Gjykimit Disiplinor” me anëtarë si më poshtë:  
Znj.Artemisi Dono  
Znj.Orjola Plaku  
Znj. Naureda Bajraktari
- Vendimi Nr.2 “Për ndryshimin e vendimit Nr.5, datë 20.12.2021 të Komisionit Etik dhe Gjykimit Disiplinor e Profesional, në dhënien e masës disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për heqjen e të drejtës së ushtrimit të profesionit”.
- Vendimi Nr.3 “Për ndryshimin e vendimit Nr.4, datë 20.12.2021 të Komisionit Etik dhe Gjykimit Disiplinor e Profesional, në dhënien e masës disiplinore “Vërejtje me shkrim”.
- Vendimi Nr.4 “Për miratimin e tarifës së honorarit për mbledhjet e Këshillit Kombëtar që vijojnë me të njëjtin rend dite në disa mbledhje pasardhëse në vlerën 2500 lekë/neto, për këdo anëtar të Këshillit Kombëtar që i bashkohet diskutimeve në mbledhjet në vijim dhe jo atë fillestare.
- Vendimi Nr.5 “Për miratimin e vendosjes së tarifës 27 lekë/faqe për tërheqje dokumentacioni nga Urdhri i Psikologut”.
- Vendimi Nr.6 “Për miratimin e propozimeve të zyrës juridike për ndryshime në Rregulloren e Edukimit në Vazhdim, përkatësisht Kreu 4, B1, Pika 1 e saj.
- Vendimi Nr.7 “Për miratimin e propozimit të zyrës juridike për hartimin e moduleve të trajnimit për psikologët në fushën e drejtësisë”.
- Vendimi Nr.8 “Për miratimin e propozimit të zyrës juridike për ngritjen e grupit ad hoc për verifikimin e kriterëve profesionale të ekspertëve psikologë të Regjistrimit Elektronik të Ministrisë së Drejtësisë.
- Vendimi Nr.9 “Për miratimin e propozimit të zyrës juridike për ndryshime në Statutin e Urdhrit të Psikologut “Të shtohet një nen i posaçëm për përfshirjen e pozicionit të Sekretarit të Përgjithshëm në organikën e Urdhrit të Psikologut”
- Vendimi Nr.10 “Për miratimin e propozimit të zyrës juridike për ndryshime në Rregulloren e Gjykimit Disiplinor e Profesional, për një shtesë në Nenin 4, Pika 3.1 si dhe Neni 12/1.
- Vendimi Nr.11 “Për ngritjen e Komisionit të numërimit të votave për anëtarët e KEVP-së”. Kandidaturat fituese dhe anëtarët e rinj të KEVP-së bazuar në rezultatin e votimit janë si më poshtë:  
Znj.Ardiana Mali  
Znj.Erika Melonashi  
Znj.Marsela Shehu  
Znj.Valmira Skëndi
- Vendimi Nr.12 “Për ndryshimin e vendimit Nr.1, Datë 15.02.2022 të Komisionit Etik dhe Gjykimit Disiplinor e Profesional, në masën disiplinore “Vërejtje me shkrim”.
- Vendimi Nr.13 “Për mosshqyrtimin e kërkesës “Për ulje tarifash për kuotizacionet dhe rregullimin e tregut, tarifave dhe ofertuesave për trajnimet e Edukimit në Vazhdim.
- Vendimi Nr.14 “Për miratimin e Buxhetit Faktik 2021.
- Vendimi Nr.15 “Për miratimin e Raportit Vjetor 2021.
- Vendimi Nr.16 “Për specifikimin e fushës së kompetencës për ushtrimin e profesionit të psikologut në fushën e drejtësisë si më poshtë:  
Nuk do mund të ushtrojnë profesionin e psikologut, në sistemin e drejtësisë (pranë institucioneve të drejtësisë të tilla si komisariatet, prokuroritë apo gjykatat), ato psikologë, të cilët nuk janë kompetentë në drejtësi dhe nuk kanë formimin e duhur akademik në ofrimin e shërbimit në këtë fushë. Konkretisht psikologët të cilët nuk kanë përfunduar ciklin e studimeve në njërin prej profileve të mëposhtme:
  - 1.Psikologji Ligjore
  - 2.Psikologji Juridike
  - 3.Psikologji Klinike
  - 4.Psikologji ForensikeÇdo psikolog, i cili ka përfunduar studimet për psikologji, por jo në profilet e lartpërmendura, nuk do mund të ndjekë dot procesin e çertifikimit si ekspert psikolog në sistemin e drejtësisë, pra nuk mund të bëhet pjesë e trajnimeve të posaçme të organizuara nga Urdhri i Psikologut për çertifikimin e tyre, sipas parashikimeve të legjislatcionit në fuqi.
- Vendimi Nr.17 “Për specifikimin e fushës së kompetencës për ushtrimin e profesionit të psikologut në fushën e drejtësisë, si më poshtë:
  - Të gjithë psikologët pjesë e regjistrimit elektronik



## URDHRI I PSIKOLOGUT RAPORTI VJETOR 2022



të cilët janë me rekomandime nga grupi *ad hoc* i verifikimit, brenda datës 23 shtator të depozitojnë pranë Urdhrit dokumentacionin plotësues si më poshtë:

- Vërtetim të rifreskuar të punës në të cilën ndodhen aktualisht
- Vërtetime që provojnë ushtrimin e profesionit të psikologut në të kaluarën (nëse i disponojnë). Të gjitha këto vërtetime të pasqyrojnë kohën e plotë të punës si psikolog ndër vite.
- Të gjitha vërtetimet e mësipërme duhet të jenë të shoqëruara me vërtetimin e pagesës së kontributeve shëndetësore e shoqërore për të gjithë kohëzgjatjen e punës si psikolog.
- Të gjithë psikologët pjesë e regjistrit elektronik dhe ata që do të bëjnë në të ardhmen trajnimin e posaçëm në drejtësi, duhet të sjellin një herë në vit pas thirrjes së Urdhrit: Vërtetim të rifreskuar të punës.
- Vendimi Nr.18 “ Për lënien në fuqi të Vendimit Nr.3 datë 26.05.2022 të Komisionit Etik e Gjykimit Disiplinor: “Vërejtje me shkrim”.
- Vendimi Nr.19 “Për miratimin e propozimin e zyrës juridike në lidhje me lehtësimin e procedurave të rilicencimit si më poshtë:

A: Për kategorinë e psikologëve të cilët janë licencuar për herë të parë gjatë vitit 2017 të aplikohet skema: Për psikologët të cilët deri në datën e përfundimit të vlefshmërisë së Licencës, kanë grumbulluar një numër kreditesh nga 65 deri në 80 kredite përgjatë 5 viteve, të rilicencohen automatikisht, me kushtin e vetëm atë të kryerjes së pagesës 200 Lekë x kredit, për numrin e krediteve të paplotësuara, bazuar në rregullore.

Për psikologët të cilët deri në datën e përfundimit të vlefshmërisë së Licencës, kanë grumbulluar një numër kreditesh nga 0 në 64 kredite, t’u lihet një afat 6 muaj për plotësimin e numrit minimal prej 80 kreditesh, afat i cili fillon menjëherë pas përfundimit të vlefshmërisë së licencës. Psikologët që nuk do të plotësojnë minimalisht 80 kredite edhe pas afatit 6 muaj, t’i nënshtrohen provimit të organizuar nga Urdhri.

Numri i Krediteve të përllogaritet si shuma totale e numrit të krediteve të përfituara gjatë 5 viteve, pa marrë në konsideratë këtu parashikimet e Rregullores së Edukimit në Vazhdim në lidhje me

fushën e kompetencës së aktiviteteve ku psikologët kanë marrë pjesë, si dhe numrin minimal të krediteve brenda 1 viti, të parashikuara në Kreun II, pika 2 të Rregullores së Edukimit në Vazhdim.

B: Për kategorinë e psikologëve të cilët janë licencuar për herë të parë në periudhën Janar-Qershor 2018 të aplikohet skema:

Për psikologët, të cilët deri në datën e përfundimit të vlefshmërisë së Licencës, nuk kanë mundur të plotësojnë numrin minimal prej 80 kreditesh, t’u lihet një afat 6 muaj për plotësimin e numrit minimal prej 80 kreditesh, afat i cili fillon menjëherë pas përfundimit të vlefshmërisë së licencës. Psikologët që nuk do të plotësojnë minimalisht 80 kredite edhe pas afatit 6 muaj, t’i nënshtrohen provimit të organizuar nga Urdhri.

Numri i krediteve të përllogaritet si shuma totale e numrit të krediteve të përfituara gjatë 5 viteve, pa marrë në konsideratë këtu parashikimet e Rregullores së Edukimit në Vazhdim në lidhje me fushën e kompetencës si dhe numrin minimal të krediteve brenda 1 viti, të parashikuara në Kreun II, pika 2 të Rregullores së Edukimit në Vazhdim.

C: Për kategorinë e psikologëve, të cilët janë licencuar për herë të parë në periudhën Korrik-Dhjetor 2018 të aplikohet skema:

Për psikologët të cilët deri në datën e përfundimit të vlefshmërisë së Licencës, nuk kanë mundur të plotësojnë numrin minimal prej 80 kreditesh, t’i nënshtrohen provimit të organizuar nga Urdhri.

Numri i krediteve të përllogaritet si shuma totale e numrit të krediteve të përfituara gjatë 5 viteve, pa marrë në konsideratë këtu parashikimet e Rregullores së Edukimit në Vazhdim në lidhje me fushën e kompetencës si dhe numrin minimal të krediteve brenda 1 viti, të parashikuara në Kreun II, pika 2 të Rregullores së Edukimit në Vazhdim.

- Vendimi Nr.20 “Për lënien në fuqi të Vendimit Nr.5 datë 07.05.2022 të Komisionit Etik e Gjykimit Disiplinor Profesional “Përjashtim nga Urdhri i Psikologut për një periudhë 1 (një) muajore”.

- Vendimi Nr.21 “Për miratimin e ndryshimeve në Rregulloren e Edukimit në Vazhdim shoqëruar me propozimet e zyrës juridike”.

- Vendimi Nr.22 “Për miratimin e arsytimit të vendimeve të KEVP-së në lidhje me aplikimet



## URDHRI I PSIKOLOGUT RAPORTI VJETOR 2022



- e psikologëve për aktivitetet e vetraportuara që janë të shtrira nga një minimum në një maksimum kreditesh.
- Vendimi Nr.23 “Për zgjedhjen e Sekretarit të Përgjithshëm të Urdhrit të Psikologut Znj.Elona Mustafaraj.
  - Vendimi Nr.24 “Për miratimin e propozimit të zyrës juridike për kategorinë e psikologëve që kanë përfituar një Licencë dhe kërkojnë të pajisen me një të dytë”.
  - Vendimi Nr.25 “Për miratimin e propozimeve të zyrës juridike për kategorinë e psikologëve që kanë studime pasuniversitare për zgjerimin e fushës së kompetencës”.
  - Vendimi Nr.26 “Për miratimin e Projekt-Buxhetit të vitit financiar 2023”.
  - Vendimi Nr.27 “Për miratimin për njohjen e krediteve në të gjitha fushat e kompetencës për kategorinë e psikologëve që kryejnë trajnime në fushën e kërkimit shkencor”.
  - Vendimi Nr.28 “Për miratimin e propozimit që fusha e kompetencës së profilit të studimit Kërkim Shkencor të bazohet në diplomën e studimeve 4-vjeçare që psikologu paraqet.



## 2.3 KOMISIONI I GJYKIMIT DISIPLINOR PROFESIONAL

Ky komision është ngritur pranë Urdhrit të Psikologut në zbatim të nenit 19 të Ligjit nr. 40/2016 “Për Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë”.

Komisioni Etikës dhe Gjyimit Disiplinor Profesional ka në strukturën e tij 5 anëtarë prej të cilëve 4 psikologë me një eksperiencë pune mbi 10-vjeçare në profesion dhe përfaqësuesin e Zyrës Juridike të Urdhrit:

Konkretisht: Dr.Enila Cenka, Dr.Brunilda Laboviti, Dr.Redina Balla, dhe juristi i Urdhrit Z.Igli Çutra

Komisioni funksionon në bazë të ligjit për Urdhrin e Psikologut, Kodit të Etikës dhe Deontologjisë si dhe Rregullores së Gjyimit Disiplinor e Profesional.

Gjatë vitit 2020 Komisioni Etik i Gjyimit Disiplinor Profesional ka shqyrtuar gjithsej 5 raste, të iniciuara nga individë të ndryshëm.

Komisioni i Etikës pas shqyrtimit të rasteve ka dhënë këto vendime:

Në 5 raste janë konstatuar shkelje të Kodit të Etikës dhe janë dhënë masa të ndryshme disiplinore kundrejt psikologëve, të tilla si: vërejtje me paralajmërim si dhe përjashtim nga UP për një periudhë 1 mujore, 10 mujore dhe 18 mujore.

Në 3 raste, pas shqyrtimit të çështjes, Komisioni Etik nuk ka konstatuar raste të shkeljes së Kodit të Etikës, ndaj kërkesat e palëve ankuese janë rrëzuar.

## KOMISIONI I PRAKTIKËS PROFESIONALE



Dr. Brunilda Laboviti



Z. Igli Çutra



Dr. Jonida Haxhiu



Dr. Redina Balla



Dr. Enila Cenka



## 2.4 KOMISIONI I EDUKIMIT NË VAZHDIM NË PSIKOLOGJI

Në bazë të akteve ligjore në fuqi, ky Komision zgjihet nga Këshilli Kombëtar dhe drejtohet nga Presidenti i Urdhrit. Në datë 08.04.2022, Këshilli Kombëtar, bazuar në nenin 16.2. ç.) të ligjit 40/2016 “Për Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë”:

### VENDOSI:

Të miratojë me unanimitet ngritjen e Komisionit të numërimit të votave për anëtarët e KEVP-së si dhe shpalljen e kandidaturave fituese.

Kandidaturat fituese dhe anëtarët e rinj të KEVP-së bazuar në rezultatin e votimit janë si më poshtë:

1. Znj.Ardiana Mali
2. Znj.Erika Melonashi
3. Znj.Marsela Shehu
4. Znj.Valmira Skëndi

Pas plotësimit të të gjitha akteve normative që e bënë atë të jetë funksional, ky Komision vijoi punën duke shqyrtuar aplikimet për akreditim dhe kërkesat për ripërsëritje të aktiviteteve të subjekteve të cilat ishin të interesuara të kryenin aktivitete të akredituara të edukimit në vazhdim në psikologji. Pjesë e rëndësishme e punës së KEVP për vitin 2022 ka qënë procesi i miratimit të krediteve në kuadër të rilicensimit për psikologët të cilët kanë qënë në fund të vlefshmërisë së licencave të tyre.

## KOMISIONI I EDUKIMIT NE VAZHDIM



Dr. Valbona Treska




Znj. Valmira Skëndii



Znj. Marsela Shehu



Znj. Erika Melonashi



Znj. Ardiana Mali



## 2.5 ADMINISTRATA E URDHRI TË PSIKOLOGUT



Administrata e Urdhrit të Psikologut përbëhet nga:  
Zyra Juridike – një punonjës, Z.Igli Çutra  
Zyra e Financës – një punonjës, Z.Lejdi Goga

Sekretariati, Protokolli, Arshiva – një punonjëse,  
Znj.Armira Baboçi  
Zyra e IT-së – një punonjës part-time, Z.Enn Tusha





## 2.6 KOMISIONE TË TJERA

Pranë Urdhrit të Psikologut funksionojnë disa komisione të tjera, të cilat janë të domosdoshme për realizimin e misionit të tij.

### 2.6.1 Komisioni i Licencimit

Ky Komision është ngritur nga Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Psikologut dhe shqyrton kërkesat për licencim të të gjithë atyre psikologëve, që në bazë të ligjit dhe akteve normative në fuqi, përjashtohen nga detyrimi për kryerjen e praktikës profesionale dhe provimit të shtetit.

Ai përbëhet nga Presidentja Znj.Valbona Treska, juristi Z.Igli Çutra, sekretaria Znj.Armira Baboçi si dhe nga anëtarët e Këshillit Kombëtar: Dr.Edvin Lame dhe Dr.Fleura Shkëmbi

Gjatë vitit 2022 ky komision ka licencuar 219 psikologë të rinj, të ndarë sipas fushave të mëposhtme:

Psikologë klinikë - 76 anëtarë

Psikologë shkollorë dhe organizacionalë – 5 anëtarë

Psikologë këshillimi - 35 anëtarë

Psikologë të përgjithshëm - 8 anëtarë

Psikologë shkollorë- 51 anëtarë

Psikologë në institucione – 18 anëtarë

Psikologë ligjorë - 2 anëtarë

Psikologë në orientim profesional - 7 anëtarë

Psikologë organizacionalë - 9 anëtarë

Psikologë edukimi - 2 anëtarë

Psikologë kriminal -1anëtar

Psikologë zhvillimore - 4 anëtarë

Psikologë këshillim klinik -1 anëtar

Gjatë vitit 2022 i janë nënshtruar procesit të vlerësimit të njohjes së krediteve dhe rilicencimit 105 psikologë.

## KOMISIONI I LICENCIMIT



Dr. Valbona Treska




Z. Edvin Lame



Dr. Fleura Shkëmbi



Znj. Armira Baboçi



Z. Igli Çutra



### 2.6.2 Komisioni i Praktikës Profesionale

Ky komision është ngritur nga Këshilli Kombëtar për efekt të zbatimit të “Rregullores së Praktikës Profesionale”, e miratuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në cilësinë e autoritetit kompetent, e cila mundëson rregullimin ligjor të vijimit të procedurave për një numër të konsiderueshëm psikologësh të sapodiplomuar dhe përjashtimin nga kjo praktikë për një kategori tjetër.

Komisioni i Praktikës Profesionale drejtohet nga Presidenti i Urdhrit dhe përbëhet nga anëtarët e zgjedhur nga Këshilli Kombëtar, konkretisht: Dr.Valbona Habili, Znj.Orjola Plaku si dhe nga juristi i Urdhrit të Psikologut, Z.Igli Çutra dhe sekretaria Znj.Armira Baboçi.

Këtë vit janë regjistruar pranë Urdhrit të Psikologut 187 praktikantë me kontrata të rregullta punësimi në institucione të ndryshme shtetërore e private.

Komisioni i Praktikës ka shqyrtuar gjatë vitit 2022 dosjet e 16 psikologëve dhe pas shqyrtimit të tyre ka vendosur:

- 9 psikologë të përjashtohen nga detyrimi i kryerjes së praktikës profesionale, bazuar në Memorandumin e Bashkëpunimit mes U.P. dhe MSHMS
- 3 psikologë janë vlerësuar se duhet të kryejnë praktikë të pjesshme profesionale.
- 5 psikologë janë vlerësuar se duhet të kryejnë praktikën e plotë profesionale.
- 2 psikologë janë vlerësuar se dokumentacioni i tyre duhet të shqyrtohet nga Komisioni i Licencimit
- 1 psikolog të plotësojë dokumentacionin e kërkuar.

### 2.6.3 Komisioni i Vlerësimit të Aftësimit Praktik

Ky komision është ngritur bazuar në Urdhrin Nr.580, datë 31.07.2019 “Për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit e Aftësimin Praktik për Profesionin e Psikologut” të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ka si qëllim të vlerësojë praktikën profesionale të supervizuar të çdo psikologu që i nënshtrohet kësaj procedure.


## KOMISIONI I PRAKTIKËS PROFESIONALE



Dr. Valbona Treska



Z. Igli Çutra



Znj. Valbona Habili



Znj. Erjola Plaku



Znj. Armira Baboçi



Me Urdhër të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, bazuar në nenin 17 të Urdhrit të përbashkët të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë, “Për miratimin e Rregullores së Praktikës Profesionale” anëtarët e këtij komisioni janë si më poshtë: Znj. Aleksandra Puci, kryetare e komisionit dhe përfaqësuese e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Z. Besmir Frroku dhe Z. Edvin Lame, përfaqësues të Urdhrit të Psikologut. Komisioni ka hartuar fillimisht pyetjet orientuese për provimin e praktikës profesionale, pyetje të cilat janë publikuar paraprakisht në Eëbsite-n e Urdhrit të Psikologut <https://www.urdhriipsikologut.al/fondi-ipyetjeve/>, sipas afateve të parashikuara në rregullore.

Gjatë vitit 2022 u zhvillua Vlerësimi i Aftësimit Praktik në datat 4-5-6-7-8-14 prill si dhe 31 tetor, 1-2 nëntor pranë ambjenteve të Urdhrit të Psikologut.

Në listën e provimit të muajit prill ishin 164 praktikantë të cilët ju nënshtruan vlerësimit të anëtarëve të komisionit të VAP-it, prej të cilëve 2 praktikantë nuk u paraqitën ditën e provimit.

Në listën e provimit të muajit nëntor ishin 70 praktikantë të cilët ju nënshtruan vlerësimit të anëtarëve të komisionit të VAP-it, prej të cilëve 3 praktikantë nuk u paraqitën ditën e provimit.

Bazuar në Nenin 19, pika 1 dhe pika 2, 65 praktikantë u vlerësuan kalueshëm, 2 praktikantë u vlerësuan jokalueshëm.

Në total gjatë vitit 2022, 227 psikologë praktikantë janë vlerësuar Kalueshëm nga KVAP, 5 psikologë nuk janë paraqitur në provim dhe 2 psikologë janë vlerësuar jokalueshëm.

## KOMISIONI I VLERËSIMIT TË AFTËSIMIT PRAKTIK



Znj. Aleksandra Puci



Z. Edvin Lame



Z. Besmir Frroku



## 2.7 KOORDINATORËT LOKALË

Ky rrjet ka si qëllim ofrimin e mbështetjes, ndihmës dhe mbrojtjes së interesave për të gjithë anëtarët e Urdhrit të Psikologut të qarkut përkatës, duke patur në fokus nevojat dhe problematikat që ata ndeshin gjatë ushtrimit të profesionit të psikologut.

Rrjeti i Koordinatorëve Lokalë funksionin në mënyrë vullnetare.

Koordinatori lokal ka si mision:

- Kryerjen e shërbimeve për anëtarët e Urdhrit, në kuadër të shpërndarjes efektive të informacioneve që lidhen me ushtrimin e profesionit, mbledhjes dhe shpërndarjes së dokumentacionit specifik, me qëllim përmirësimin e cilësisë së ushtrimit të profesionit të psikologut në institucionet përkatëse rajonale dhe uljen e kostove për përfitimin e këtyre shërbimeve për anëtarët e Urdhrit në rajon
- Vendosjen dhe ruajtjen e marrëdhënieve të Urdhrit me organet vendore dhe subjektet e tjera publike dhe private në rajon, me qëllim rritjen e ndikimit dhe faktorizimin e Urdhrit të Psikologut.

Disa nga funksionet që kryejnë Koordinatorët Lokalë janë:

- Dhënia e informacionit të detajuar për çdo psikolog, i cili do të kryejë procedurat e anëtarësimit, licencimit, zhvillimit të praktikës profesionale, provimit të shtetit, kryerjen e trajnimeve të ndryshme, etj.
- Mbledhja e të gjitha dokumentave të nevojshme të psikologëve të rajonit përkatës, përsa i përket procedurës së anëtarësimit-licencimit, si dhe të çdo dokumenti tjetër që lidhet me Urdhrin, dhe përcjellja e tyre pranë Urdhrit të Psikologut.
- Shpërndarja për psikologët e rajonit përkatës të lejes së ushtrimit individual të profesionit (Licencave Profesionale) apo e çdo dokumentacioni tjetër të lëshuar nga Urdhri për anëtarët e këtij rajoni.
- Krijimi dhe ruajtja e marrëdhënieve të bashkëpunimit, brenda rajonit, me institucionet publike, si dhe me çdo subjekt tjetër publik apo privat, që ka qëllime të përbashkëta me Urdhrin e Psikologut.
- Informimi i psikologëve të rajonit lidhur me

vendimet dhe udhëzimet e Urdhrit të Psikologut.

- Mbështetja për organizimin dhe zhvillimin e veprimtarive studimore e shkencore në fushën e psikologjisë në rajon.
- Gjithashtu, Koordinatorët Lokalë pranojnë çdo ankesë të ardhur në drejtim të psikologëve, së bashku me të gjithë dokumentacionin shoqërues, dhe e dërgojnë atë pranë Zyrës Qendrore të Urdhrit të Psikologut, me qëllim inicimin e procedurave të shqyrtimit nga Komisioni Etik i Gjykimit Disiplinor Profesional.

Aktualisht, shpërndarja e rrjetit të koordinatorëve është si më poshtë:

### **Koordinatori Lokal për Qarkun e Shkodrës**

Migena Burrja/Haxhi

Adresa: Rr "At Gjergj Fishta" Nd.37 Kati I-rë

Tel: 0693129434

e-mail: [Qarkushkoder@urdhriipsikologut.al](mailto:Qarkushkoder@urdhriipsikologut.al)

### **Koordinatori Lokal për Qarkun e Vlorës**

Veliona Hoxhaj

Adresa: Rr "Sulejman Delvina" Lgj Hajro Cakerri,  
Pall Lor, Kati II-të

Tel: 0674060444

e-mail: [Qarkuvlore@urdhriipsikologut.al](mailto:Qarkuvlore@urdhriipsikologut.al)

### **Koordinatori Lokal për Qarkun e Lezhës:**

Znj.Alma Shyti

Adresa:Shkolla "Kolin Gjoka"

Tel: 0683296435

e-mail: [Qarkulezhe@urdhriipsikologut.al](mailto:Qarkulezhe@urdhriipsikologut.al)

### **Koordinatori Lokal për Qarkun e Korçës:**

Znj.Elizaveta Dino

Adresa: Qendra e Shëndetit Mendor, Korçë

Tel.: 0696171870

e-mail: [Qarkukorce@urdhriipsikologut.al](mailto:Qarkukorce@urdhriipsikologut.al)



**URDHRI I PSIKOLOGUT  
RAPORTI VJETOR 2022**



**Koordinatori Lokal për Qarkun e Elbasanit**

Znj. Jonida Mustafaraj

Adresa: Qendra Shqiptare për Integrimin e Njerzve  
me Nevoja të Vecanta

Tel: 0693847103

e-mail: [Qarkuelbasan@urdhriipsikologut.al](mailto:Qarkuelbasan@urdhriipsikologut.al)

**Koordinatori Lokal për Qytetin e Lushnjës**

Znj. Fatmira Lala

Adresa: Shkolla "Kongresi i Lushnjes"

Tel: 0692626443

e-mail: [koordinatorkallushnje@urdhriipsikologut.al](mailto:koordinatorkallushnje@urdhriipsikologut.al)

**Koordinatori Lokal për Qarkun e Gjirokastrës**

Znj. Loreta Mamani

Adresa: Gjirokastrë

Tel: 0694640798

e-mail: [Qarkugjirokaster@urdhriipsikologut.al](mailto:Qarkugjirokaster@urdhriipsikologut.al)

**Koordinatori Lokal për Qarkun e Dibrës**

Znj. Arta Beqiri

Adresa: Bulqizë

Tel: 0698220502

e-mail: [Qarkudiber@urdhriipsikologut.al](mailto:Qarkudiber@urdhriipsikologut.al)



### 3. ANËTARËSIA E URDHRI TË PSIKOLOGUT

Për të qenë anëtar i Urdhrit të Psikologut në Republikën e Shqipërisë, psikologët duhet të përmbushin kriteret e mëposhtme:

Të kenë diplomën e studimeve të larta “Bachelor” dhe “Master shkencor” ose “Master profesional” në psikologji ose ekuivalent me të, sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë, lëshuar nga institucioni i arsimit të lartë, brenda apo jashtë vendit, të njohura nga ministria përgjegjëse për arsimin;

Të mos jenë të dënuar me vendim gjykate të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale, që lidhet me ushtrimin e profesionit, në momentin e kërkesës për anëtarësim.

#### 3.1 PSIKOLOGË TË LICENCUAR

Licencimi i psikologëve rregullohet në bazë të Ligjit “Për Profesionet e Rregulluara në Republikën e Shqipërisë”. Sipas këtij ligji, pas përmbylljes së studimeve Bachelor dhe Master në psikologji, duhet të kryhet praktika një vjeçare profesionale dhe më pas të jepet provimi i shtetit, si parakusht për licencimin.

Përrjashtimisht, në këtë ligj parashikohet se psikologët, të cilët e kanë ushtruar profesionin përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, përjashtohen nga detyrimi për të dhënë provimin e shtetit.

Anëtarësia ka patur një rritje gjatë vitit 2022. Administrata e Urdhrit dhe Koordinatorët Lokalë në vazhdimësi kanë bërë një punë të madhe sensibilizuese kundrejt psikologëve, por edhe kundrejt institucioneve publike e private, të cilat janë ndërgjegjësuar për nevojën e zbatimit të ligjit.

Në total Urdhri i Psikologut për vitin 2022 ka arritur në 1389 anëtarë të regjistruar aktivë prej të cilëve janë 202 anëtarë të rinj të regjistruar për herë të parë gjatë këtij viti.

Në përmbushje të detyrimeve ligjore, Urdhri ka vijuar procesin e licencimit për këtë kategori të psikologëve, bazuar në Ligjin Nr.10171, datë 22.10.2009, “Për profesionet e rregulluara në R.Sh”<sup>1</sup> dhe Memorandumin e Bashkëpunimit mes ish-Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë dhe Urdhrit të Psikologut.

<sup>1</sup> Neni 9 i Ligjit Nr.10 171, datë 22.10.2009 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), pika 4.:Përrjashtohet nga detyrimi për të dhënë provimin e shtetit: a) profesionisti që, në çastin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, ushtron ose ka ushtruar një profesion të rregulluar;



## URDHRI I PSIKOLOGUT RAPORTI VJETOR 2022



Aktualisht , licencimi i psikologëve sipas fushës së kompetencës paraqitet si më poshtë:

Psikologë të licencuar sipas viteve	2017	2018	2019	2020	2021	2022	Total
Total të Licencuar	<b>307</b>	<b>175</b>	<b>71</b>	<b>101</b>	<b>74</b>	<b>130</b>	<b>950</b>
Psikologë Klinikë	147	97	32	32	35	80	423
Psikologë Shkollorë Organizacionalë	48	19	14	7	4	4	96
Psikologë Shkollorë	28	14	3	27	11	51	134
Psikologë Organizacionalë	8	13	2	7	5	10	45
Psikologë në Institucione	17	6	3	5	3	18	52
Psikologë në Orientim Profesional	9	3	2	1	2	7	24
Psikologë në Këshillim Psikologjik	41	25	9	18	10	36	136
Psikologë në Kërkim Psikologjik	5	2	2	1	-	-	10
Psikologë Ligjorë	5	2	2	3	2	2	16
Psikologë të Përgjithshëm	8	2	6	2	1	8	27
Psikologë Komuniteti	2	-	-	1	-	-	3
Psikologë në Rehabilitim psikologjik	1	-	-	-	-	-	1
Psikologë Edukimi	-	-	-	1	1	2	4
Psikologë Zhvillimi	-	-	-	1	1	-	2
Gjuhesi Klinike	-	-	-	-	1	-	1
Psikopatologji Klinike	-	-	-	-	1	-	1
Kriminale	-	-	-	-	-	1	1
Këshillim Klinik	-	-	-	-	-	1	1
Shkollore dhe Zhvillimi	-	-	-	-	-	4	4

Gjatë vitit 2022 janë licencuar në mënyrë të drejtëpërdrejtë 29 psikologë dhe 91 të tjerë me Provim Shteti, në total 130 psikologë të rinj.

I janë nënshtruar procesit të rilicencimit 105 psikologë.



## 4. ZHVILLIMI PËR HERË TË PARË I PROVIMIT TË SHTETIT PËR PSIKOLOGË

Pas shumë e shumë përpjekjeve dhe një periudhe të gjatë kohe pritjeje, u zhvillua në datat 18,19 dhe 20 Maj 2022 Provimi i Shtetit për Psikologët për herë të parë.

Në këtë provim kanë marrë pjesë psikologë, të cilët kishin përfunduar ushtrimin e Praktikës Profesionale, si dhe psikologë të cilët ishin përjashtuar me vendim të Komisionit të Praktikës dhe ishin në pritje vetëm të zhvillimit të Provimit të Shtetit, për t'u pajisur me licencë. Gjithsej në total gjatë të tre ditëve të zhvillimit të provimit morën pjesë 267 psikologë.

Provimi i Shtetit ishte i organizuar në një mënyrë të tillë ku pjesën më të madhe pyetjeve e përmbante ciliki Bachelor, konkretisht në masën 70% të pyetjeve në total, ndërsa pjesa tjetër ishin pyetje nga cikli Master, i ndarë sipas 5 fushave: Psikologji në fushën e Shëndetit Mendor, Psikologji në fushën e Edukimit, Psikologji në fushën e Punës dhe Organizacionale, Psikologji në fushën Juridike dhe Psikologji në fushën Sociale dhe të Komunitetit.

Kalueshmëria në % e psikologëve, të cilët i'u nënshtruan provimit, të ndarë sipas fushave të kompetencës.

- 1.Psikologë në fushën e Shëndetit Mendor
- 2.Psikologë në fushën e Edukimit
- 3.Psikologë në fushën Punë dhe Organizacionale
- 4.Psikologë në fushën Juridike

Kalueshmëria 80%  
Kalueshmëria 60%  
Kalueshmëria 59%  
Kalueshmëria 33 %

Në datën 20.12 2022 u realizua Provimi i Shtetit për Psikologët për herë të dytë.

Në këtë provim kanë marrë pjesë psikologë, të cilët kishin përfunduar ushtrimin e Praktikës Profesionale, psikologë të cilët ishin përjashtuar me vendim të Komisionit të Praktikës dhe ishin në pritje vetëm të zhvillimit të Provimit të Shtetit, për t'u pajisur me

licencë, si edhe kategoria e psikologëve të cilët nuk rezultuan kalues në Provimin e Parë të Shtetit apo munguan në këtë provim. Gjithsej në këtë provim morën pjesë 152 psikologë.

Kalueshmëria në % e psikologëve, të cilët i'u nënshtruan provimit, të ndarë sipas fushave të kompetencës.

- 1.Psikologë në fushën e Shëndetit Mendor
- 2.Psikologë në fushën e Edukimit
- 3.Psikologë në fushën Punë dhe Organizacionale
- 4.Psikologë në fushën Juridike

Kalueshmëria 66 %  
Kalueshmëria 46 %  
Kalueshmëria 45 %  
Kalueshmëria 80%





## 5. BUXHETI

### 5.1 TË ARDHURAT

Projekt-Buxheti i vitit 2022 parashikonte mbledhjen e të ardhurave në masën 14,880,000.00 lekë. Duke e krahasuar me realizimin e buxhetit faktik të vitit 2022 kemi një tejkalim nga parashikimi i mbledhjes së të ardhurave nga aktiviteti i kryer nga

institucioni gjatë këtij viti, në masën 16,427,980.00 lekë ose me rreth 10.4%.

Zërat kryesorë të të ardhurave për vitin fiskal 2022 janë:

Emërtimi i zërave	Të ardhura në total
Të ardhura nga tarifa e anëtarësimit	694,845.00
Të ardhura nga kuotizacionet vjetore	8,577,905.00
Të ardhura nga tarifa e licensimit	3,776,450.00
Të ardhura nga botime dhe publikime	9,000.00
Të ardhura nga tarifa për Edukimin në vazhdim	2,661,415.00
Të ardhura nga vërtetime anëtarësie	17,800.00
Të ardhura nga Komisioni i Vlerësimit të Aftësisit Praktik	690,565.00
Të ardhura të tjera të ligjshme	-
<b>Totali i të ardhurave</b>	<b>16,427,980.00</b>

Nga informacioni i marrë nga tabela e mësipërme rezultojnë se është realizuar një total të ardhurash neto të pakufizuara në vlerën 16,427,980.00 lekë, ku kryesisht grumbullimi i këtyre të ardhurave konsiston

në tarifen vjetore të kuotizacionit sipas kategorive të anëtarëve, tarifën për tërheqjen e kartonit të licenses, si dhe totali i të ardhurave të mbledhura nga aktivitetet e edukimit në vazhdim.

### 5.2 SHPENZIMET

Nisur nga eksperiencia e viteve të kaluar, për efekt të disiplinimit sa më transparent të të ardhurave, kemi ruajtur një balancë të shpenzimeve të detyrueshme për t'u realizuar sipas planifikimit.

Sipas Projekt-Buxhetit të vitit 2022, ishte parashikuar realizimi i shpenzimeve të miratuara sipas zërave si më poshtë:

Paga	4,610,328.00 lekë
Shpenzime operative	8,869,672.00 lekë
Shpenzimet kapitale	1,400,000.00 lekë

Duke mbajtur në konsideratë parashikimet për kryerjen e shpenzimeve, më poshtë do gjeni të pasqyruara në tabelën përmbledhëse shpenzimet faktike të ndara sipas zërave për vitin 2022.



## URDHRI I PSIKOLOGUT RAPORTI VJETOR 2022



Emërtimi i zërave	Shpenzime në total
Shpenzime për paga	4,635,757.00
Shpenzime për sigurimet shoqërore dhe shëndetsore	764,730.00
Shpenzime për honorare	3,336,117.00
Shpenzime për qera	807,400.00
Shpenzime administrative të funksionimit	1,308,905.00
Shpenzime për aktivitete dhe mardhënie ndërkombëtare	1,916,778.00
Shpenzime për printime, publikime dhe menaxhimi në ëeb	524,240.00
Shpenzime për veprime bankare	60,810.00
<b>Totali i shpenzimeve operative</b>	<b>8,718,980.00</b>
Shpenzime amortizimi për inventar zyre	83,102.00
Shpenzime amortizimi për pajisje informatike	80,487.00
<b>Totali i shpenzimeve të amortizimit</b>	<b>163,589.00</b>
<b>Totali i shpenzimeve vjetore</b>	<b>13,518,326.00</b>

Në zërin e shpenzimeve operative janë shpenzuar 8,718,980.00 lekë. Kjo vlerë ka ardhur si rezultati i realizimit të të gjithë zërave që përfshihen në kategorinë e shpenzimeve operative dhe ka bërë të mundur vazhdimësinë e punës së institucionit në kushte normale.

Gjatë vitit 2022 zëri i shpenzimeve “amortizimi kapital” është zhvlerësuar në masën 163,589.00 lekë, ku llogaritja e zhvlerësimit paraqitet me vlerën e drejtë dhe me pas kjo kosto amortizohet sipas metodës së Interesit Efektiv marrë nga (SKK) duke zbritur çdo humbje apo zhvlerësim.



## URDHRI I PSIKOLOGUT RAPORTI VJETOR 2022



Më poshtë paraqitet e detajuar në zëra një tabelë faktike të vitit fiskal 2022. përmbledhëse e të ardhurave dhe shpenzimeve

Emërtimi i zërave	Të ardhura në total
Të ardhura nga tarifa e anëtarësimit	694,845.00
Të ardhura nga kuotizacionet vjetore	8,577,905.00
Të ardhura nga tarifa e licensimit	3,776,450.00
Të ardhura nga botime dhe publikime	9,000.00
Të ardhura nga tarifa për Edukimin në vazhdim	2,661,415.00
Të ardhura nga vërtetime anëtarësie	17,800.00
Të ardhura nga komisioni i Vlerësimit të Aftësisimit Praktik	690,565.00
Të ardhura të tjera të ligjshme	-
<b>Totali i të ardhurave</b>	<b>16,427,980.00</b>
Shpenzimet	Shpenzime në total
Paga	4,635,757.00
Shpenzime operative	8,718,980.00
Shpenzime amortizimi	163,589.00
Totali i shpenzimeve	13,518,326.00
Mbetja për vitin pasardhës	2,909,654.00

Siç shihet, buxheti faktik i vitit 2022 ka ruajtur një balancë të qëndrueshme midis të ardhurave dhe shpenzimeve, duke vijuar ruajtjen e stabilitetit ekonomik të institucionit, si dhe reflekton ambicien për të kaluar në një fazë më të konsoliduar të funksionimit të Urdhrit, me qëllim që aktiviteti i tij të bëhet sa më i

ndjeshëm në politikat kombëtare dhe ndërkombëtare, të jetë sa më i prekshëm për anëtarësinë dhe, mbi të gjitha, të përmbushë misionin ligjor për të cilin është krijuar në bazë të ligjit 40/2016 për “Urdhrit e Psikologut në Republikën e Shqipërisë”.



## 6. OBJEKTIVAT E REALIZUARA GJATË VITIT 2022

- Vazhdimi i procesit të formalizimit të ushtrimit të profesionit, nëpërmjet rritjes së numrit të psikologëve të regjistruar si anëtarë të Urdhrit.
- Realizimi në vazhdimësi i provimeve të Vlerësimit të Aftësisimit Praktik, si parakusht i pjesëmarrjes në Provimin e Shtetit.
- Realizimi i Provimit të Shtetit në bashkëpunimin me Qendrën e Shërbimeve Arsimore, për herë të parë për psikologët.
- Realizimi i procesit të njohjes së krediteve për kategorinë e psikologëve që kishin përfunduar vlefshmërinë e lejes së ushtrimit të profesionit.
- Rregullimi i profesionit nëpërmjet fushës së kompetencës për të gjithë psikologët që e ushtrojnë profesionin.
- Fuqizimi i rolit të psikologut në fushën e Drejtësisë dhe ofrimi i trajnimeve të vazhdueshme për këtë kategori psikologësh sipas fushës së kompetencës.
- Fuqizimi nëpërmjet informimit dhe ndërgjegjësimit të psikologëve, në lidhje me ushtrimin e profesionit të psikologut brenda fushave të tyre të kompetencës.
- Organizimi, në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtar dhe vendas, i cikleve të trajnimeve apo leksioneve të hapura, me qëllim formimin e psikologëve të specializuar për ndërhyrje në situata dhe problematika të caktuara.
- Rritja e bashkëpunimit me Federatën Europiane të Psikologëve me qëllim rritjen e standardeve profesionale.
- Rritja e bashkëpunimit me Shoqatën Europiane të Psikologëve të Punës dhe Organizacionalë (EAËOP), duke synuar përfaqësimin e Shqipërisë në komisionin e përhershme dhe grupet e punës të kësaj organizate.
- Sensibilizimi dhe fuqizimi i rolit të psikologut organizacional dhe ndërmarrja e nismave për aplikimin në vend të psikologjisë organizacionale në institucione publike dhe private.



## 7. OBJEKTIVAT PËR VITIN 2023

Objektivat që institucioni ynë synon të realizojë përgjatë vitit 2023 janë:

- Vazhdimi i procesit të formalizimit të ushtrimit të profesionit, nëpërmjet rritjes së numrit të psikologëve të regjistruar si anëtarë të Urdhrit.
- Realizimi në vazhdimësi i provimeve të Vlerësimit të Aftësisimit Praktik, si parakusht i pjesëmarrjes në provimin e shtetit.
- Realizimi në vazhdimësi i organizimit të Provimit të Shtetit për psikologët nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë me Qendrën e Shërbimeve Arsimore.
- Realizimi i provimit të rilicensimit për kategorinë e psikologëve që nuk kanë arritur të përmbushin numrin e krediteve të nevojshme për të rinovuar Lejen e Ushtrimit të Profesionit.
- Vazhdimi i zgjerimit të rrjetit të koordinatorëve lokalë
- Vazhdimi i punës për rregullimin e profesionit nëpërmjet fushës së kompetencës për të gjithë psikologët që e ushtrojnë profesionin.
- Ofrimi ofrimi i trajnimeve të vazhdueshme për kategorinë e psikologëve për të cilët tregu nuk ofron trajnime, me qëllim përmbushjen e kriterëve të Edukimit në Vazhdim.
- Fuqizimi nëpërmjet informimit dhe ndërgjegjësimit të psikologëve, në lidhje me ushtrimin e profesionit të psikologut brenda fushave të tyre të kompetencës.
- Organizimi, në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtar dhe vendas, i cikleve të trajnimeve, me qëllim formimin e psikologëve të specializuar për ndërhyrje në situata dhe problematika të caktuara.
- Rritja e bashkëpunimit me Federatën Evropiane të Psikologëve dhe Shoqatën e Psikologëve Amerikanë, me qëllim rritjen e standardeve profesionale.
- Angazhimi për hartimin e projekt-propozimit dhe aplikimi për ngritjen e Komitetit Shqiptar pranë UP për marrjen e Certifikatës EuroPsy.
- Rritja e bashkëpunimit me Shoqatën Evropiane të Psikologëve të Punës dhe Organizacionalë (EAWOP), duke synuar përfaqësimin e Shqipërisë në komisionet dhe grupet e punës të kësaj organizate.

